



14 MAJ 2015

DITA MEMORIALE E GORANËVE MË 6 MAJ: NJË MUNDËSI E HUMBUR PËR INSTITUCIONET KOSOVËS

Më 6 maj pjesëtarët e komunitetit goran tradicionalisht mblidhen në kodrat e Vllashkës të rajonit të Gorës për të festuar fillimin e pranverës. Kjo ditë konsiderohet si ditë kombëtare e pjesëtarëve të komunitetit goran dhe është e njohur si ditë memoriale e goranëve në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës.¹ Kjo ditë shërben si një rast i mirë për të nxjerrë në pah disa nga çështjet me të cilat ballafaqohet komuniteti goran në Kosovë.

Goranët janë një nga komunitetet më të vogla në mesin e komuniteteve pakicë në Kosovë, me një numër të përgjithshëm prej rreth 11,000 pjesëtarëve. Shumica e tyre jetojnë në një zonë malore në pikën më jugore të Kosovës. Por, ka fshatra të banuara me pjesëtarë të komunitetit goran që gjenden përtej kufirit në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë. Një hulumtim në terren i kryer nga Rrjeti i OSHC-ve të komunitetit goran "GORA", një koalicion i organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetin goran e themeluar me mbështetjen e ECMI Kosovës, ka identifikuar shqetësime të mëdha në mesin e pjesëtarëve të komunitetit sidomos në lidhje me çështjen e punësimit, kujdesit shëndetësor, edukimit të përgjithshëm të pjesëtarëve të komunitetit goran, dhe çështjeve të ndërlidhura me pushtetin vendor.²

Në prag të ditës kombëtare të goranëve, të hënën më 4 maj, një delegacion i përfaqësuar nga Rrjeti i OSHC-ve të komunitetit goran "Gora" u prit për një takim të shkurtër nga Kryeministri Isa Mustafa. Kjo ishte vetëm hera e parë që përfaqësuesit e shoqërisë civile të komunitetit goran patën rastin të takohen me përfaqësuesit më të lartë të qeverisë së Kosovës. Përfaqësuesit e rrjetit "Gora" e informuan Kryeministrin për disa nga çështjet më të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit goran në Kosovë dhe i kërkuan atij rritjen e përpjekjeve të qeverisë në adresimin e këtyre çështjeve. Takimi është raportuar të ketë qenë shumë i përzemërt dhe Kryeministri ka garantuar mbështetjen e plotë të qeverisë së Republikës së Kosovës për pjesëtarët e komunitetit goran.

Përfaqësuesit e rrjetit "Gora" e kanë ftuar Kryeministrin për të marrë pjesë në festimet që do të ndodhnin në rajonin e Gorës më 6 maj. Kryeministri, megjithatë, nuk ka mund të pranojë ftesën për shkak të orarit tashmë shumë të ngjeshur me shumë aktivitete të tjera, por premtoi se do të vizitojë rajonin e Gorës në një rast tjetër. Përveç një përfaqësuesi të Sekretariatit të Këshillit konsultativ për komunitete në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës, asnjë përfaqësues tjetër zyrtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo qeverisë lokale të Komunës së Dragashit nuk është parë të ketë marrë pjesë në festimet e 6 majit.

¹ [Ligji për festat zyrtare në Republikën e Kosovës](#) (21 maj 2008), Neni 5.

² ECMI Kosova. [‘Punësimi në rajonin e Dragashit’](#) (18 nëntor 2014); ECMI Kosova. [‘Procesi i decentralizimit në rajonin e Dragashit’](#) (18 nëntor, 2014); ECMI Kosova. [‘Kthimi në shkollat amë në rajonin e Dragashit’](#) (18 nëntor 2014).

Kjo është një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës, meqë do të kishte qenë një gjest shumë simbolik që do të tregonte se qeveria është në të vërtetë e shqetësuar për pozitën e pjesëtarëve të komunitetit goran në Kosovë. Mungesa e përfaqësuesve zyrtarë të Kosovës konfirmoi ndjenjën që ekziston në mesin e shumë pjesëtarëve të komunitetit goran që autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës janë duke injoruar komunitetin goran dhe se përpjekjet e përfaqësuesve të komunitetit për të krijuar kontakte dhe bashkëpunim më të drejtpërdrejtë me qeverinë e Republikës së Kosovës (më e rëndësishmja nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Këshillin konsultativ për komunitete), nuk janë marrë si përpjekje serioze.

Një mysafir që është vërejtur të ketë marrë pjesë në festimet e 6 majit, ishte Aleksandar Vulin, Ministër i punës, punësimimit dhe politikave sociale të Republikës së Serbisë, i cili ishte i shoqëruar nga një numër i politikanëve serbë të Kosovës. Vulin me këtë rast ka hapur një zyrë për punësim dhe një qendër për kërkimin të punës në komunën paralele serbe të Gorës e vendosura në fshatin Vranishtë të Komunës së Dragashit.³ Vizita e Vulin-it simbolizon përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Serbisë për të mbajtur lidhje të forta me komunitetin goran.

Politikanët serbë në mënyrë të përsëritur kanë propaganduar për zyrtarizimin e Komunës aktuale paralele të Gorës në kuadër të sistemit të Republikës së Kosovës si dhe përfshirjen e mëvonshme të kësaj komune në Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Kjo komunë do të përfshinte pjesën jugore të komunës aktuale të Dragashit ku goranët do të ishin shumicë.⁴ Shumë nga pjesëtarët e komunitetit goran e mbështesin këtë kërkesë, pasi që do të garantonte funksionimin e vazhdueshëm të institucioneve serbe në këtë pjesë të Kosovës si dhe do t'i lejonte ata që të hynin në një bashkëpunim më të drejtpërdrejtë me institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.⁵

Pjesëtarët e komunitetit goran e gjejnë veten në një pozitë veçanërisht të cenueshme për shkak të qasjes së kufizuar në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, dhe në vetëqeverisjen lokale në kuadër të sistemit të Republikës së Kosovës dhe për shkak se atyre po u duhet të mbështeten tek institucionet paralele serbe në Kosovë për shumicën e këtyre shërbimeve. Prandaj, është e domosdoshme që Qeveria e Republikës së Kosovës të shtojë përpjekjet e saj në mënyrë që shërbimet e ofruara të mbërrijnë pjesëtarët e komunitetit goran dhe të vendosen lidhje të qëndrueshme institucionale. Takimi mes kryeministrit dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të mbledhur në rrjetin e OSHC-ve "Gora" është vetëm një hap fillestar në këtë drejtim.

³ <http://www.tanjug.rs/multimedia.aspx?izb=v&GalID=161773>.

⁴ Për më shumë në lidhje me komunën e Gorës dhe përfshirjen e saj të parashikuar në Asociacionin e komunave me shumicë serbe, shihni Adrian Zeqiri dhe Pieter Troch (ECMI Kosova). '[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv i bazuar në përkatësinë etnike?](#)' (31 mars 2015).

⁵ ECMI Kosova. '[Decentralizimi në rajonin e Dragashit](#)' (18 nëntor 2014).

Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:

[Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan](#)

10 maj, 2015

[Buxhetet e komunave veriore të Kosovës: Marrëveshje më në fund](#)

7 maj, 2015

[Incidentet dhe tensionet në Mitrovicë: Nevoja për raportim objektiv dhe forcim të sundimit të ligjit](#)

21 prill, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

16 prill, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)

31 mars, 2015

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)

10 mars, 2015

[Deklarata kontroverze e Ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

5 mars, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

22 shkurt, 2015

[Një sistem juridik dhe gjyqësor i unifikuar në Kosovë?](#)

15 shkurt, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

8 shkurt, 2015

[Thirrje për arsye dhe veprim në prag të protestave në Prishtinë](#)

25 janar, 2015

[Farkimi i një mjedisi pune në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë dhe i bën thirrje autoriteteve në Kosovë që të sigurojnë qasje të lirë dhe të papenguar në objektet e kultit](#)

7 janar, 2015

[Formimi i qeverisë së re të Kosovës, përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe sfidat në të ardhmen](#)

10 dhjetor, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit

INFORMATION BULLETIN

kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.